

PËRMBLEDHJE – JO TEKNIKE

**AKTIVITETI: LINJË PRODHIMI BETONI TË SUBJEKTIT
RE & AL SH.P.K.**



AKTIVITETI: LINJË PRODHIM BETONI.
SUBJEKTI: RE & AL SH.P.K.
INVESTITORI: DYLEJMAN ZEKA
VENDNDODHJA: LEKAJ, KAVAJË.

Qëllimi i veprimtarisë

Projekti i propozuar për t'u pajisur me Leje Mjedisore Tipi B ka si qëllim funksionimin e "Fabrikës për prodhimin e betonit dhe elementëve të ndryshëm prej betoni nga subjekti "RE&AL" sh.p.k.

Për një funksionim sa më optimal dhe me cilësi që synohen të ofrohen, janë ndërtuar objektet dhe infrastruktura e cila do mbështesë aktivitetin e mësipërm. Investitori po zhvillon prej vitesh këtë veprimtari, ka mjetet e nevojshme teknike dhe një staf të caktuar posaçërisht për këtë aktivitet, ka si synim ruajtjen e shtretërve të lumenjve dhe guroreve sipas ligjeve, akteve ligjore dhe nënligjor, urdhëresave dhe udhëzimeve për këtë synim, mbajtjen pastër të rrugëve dhe shesheve përbërëse të tij, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njeriut si dhe mbrojtjen e mjedisit në zbatim të ligjeve të dala në vite për të minimizuar ndotjet.

Ndërtimi i kësaj linje ka për qëllim të realizojë prodhimin e betonit të markave të ndryshme. Ky prodhim që përdoret në industrinë e ndërtimit si në objektet sociale dhe ato industriale është i markave të ndryshme; marka 200, marka 250, marka 300, marka 350, marka 400. Këto lloje marka betoni përdoren në lidhjen e elementëve të veçantë si tulla, blloqe betoni, gurë artificialë, pllaka poroze dhe jo poroze të çdo lloj dimensionimi duke ruajtur cilësinë ndaj sizmicitetit si dhe ndaj ujërave sulfate të cilat shkaktojnë dëmtimin e betonit të markave të ndryshme. Po kështu cilësia e betonit duhet të jetë e tillë që t'i rezistojë temperaturave dhe agjentëve atmosferikë.

Kjo permbledheje e RVNM-se është hartuar për të identifikuar ndikimet negative në mjedis të kësaj veprimtarie dhe propozimet për masat zbutëse të tyre. Duhet thënë se specialistët e studiove mjedisore kanë pasur për bazë Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe aktet e tjera normative që lidhen me të"; Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", neni 20 "Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B" dhe për vlerësimin paraprak shtojcën II-të pika 5/b.

Në shfrytëzimin e linjës së prodhimit të betonit, elementeve të tjere prej betoni nga "RE&AL" sh.p.k. subjekti do të marrë të gjitha masat për zbatimin me përpikmëri të projektit të hartuar që ai të sigurojë një zhvillim normal të procesit të prodhimit, pa dëmtuar mjedisin.

Aktiviteti i subjektit të sipërpërmendur është ndërmarrë si një iniciativë që do të tentojë përveç rritjes së fitimit të investitorit edhe në:

- Shfrytëzimin dhe përdorimin e lëndës së parë në vend;
- Rritjen e punësimit në zonën përreth;
- Përmirësimin e sistemit rrugor në nivele lokale.

Shfrytëzimi i linjës së prodhimit të betonit, elementeve të tjere prej betoni nga subjekti "RE&AL" sh.p.k. nëpërmjet një zbatimi korrekt të teknologjisë, zbatimit dhe respektimit të ligjeve mjedisore do të sjellë rregullimin e ekuilibrave natyrorë, gjë që më parë nuk është arritur nga shumë subjekte për shkak të një shfrytëzimi pa kriter dhe pa rregulla sipas një ligjeshmërie të caktuar shkencore.

Vendndodhja dhe Përshkrimi i instalimit.

Shoqëria RE & AL Sh.p.k. me Administrator Z.Dylejman Zeka, ushtron aktivitetin në Lekaj Kavaje Qarku Tirane, në truallin e marre me qera në zonen kadastrale Nr.1932, me numner pasurie 281/19. Shoqëria ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj prodhimin e betonit për ndërtim.

Kordinatat e aktivitetit.

Nr	X	Y
1	4381850.61	4556336.11

Në menyre të përmbledhur të dhënat e kësaj linje prodhimi betoni përmbledhen si më poshtë:

Sipërfaqja totale e objektit	5010 m ²
Kapaciteti i dy inpianteve prodhimit të betonit	40- 60 m ³ / ore

Cikli i punës do të jetë me një ndërresë 8 oreshe/ditë dhe parashikohet të punohet rreth 264 ditë/vit.

Alternativa e analizuar.

Përzgjedhja e kësaj zone ka ardhur si rrjedhojë e përfshirjes së kësaj parcele në zonën industriale nën juridiksionin e Njesise administrative Luz. Nuk është përzgjedhur alternativë tjetër për realizimin e këtij projekti. Zonimi funksional përcakton qartë sistemin rrugorë që lidh zonën me rrugët ekzistuese. Trualli në fjalë është plotësuar me të gjitha ndërtimet e nevojshme për një objekt konform kushteve teknike ku nuk do të mungojnë parkimi, rrugë të brendshme si dhe ndarja nga rruga kryesore me breza të gjelbëruar.

Qëllimi i projektit të Shoqërisë “RE &AL” sh.p.k në kuadër të aktivitetit të saj ndërtimor në kete njesi administrative Qendër, është të prodhojë beton në fabrikën me kapacitet përpunues maksimal prej 60m³ / orë duke marrë lëndën e parë nga subjekte të licensuara për prodhimin e tyre (shkëmbore dhe lumore) në përputhje plotësisht me synimin e shoqërisë që t’i afrohet tregut të përdorimit të materialeve të ndërtimit, si materiale të gatshme për sektorin e ndërtimit.

Gjithashtu sheshi është larg qendrave të banuara. Impianti është projektuar sipas normave Europiane për mbrojtjen e mjedisit si në lidhje me ndotjen nga pluhurat ashtu edhe me ndotjen akustike. Shoqëria do të aplikojë një teknologji për prodhimin e materialeve të ndërtimit, e cila karakterizohet për thjeshtësinë e saj dhe siguron ruajtjen e mjedisit në të gjitha aspektet. Këto impiante janë projektuar për të patur ndotje të ujit apo ajrit sa më të pakta, dhe lënda e parë materiale inerte, çimento, granili, rëra shfrytëzohen plotësisht duke mos krijuar mbetje teknologjike.

Për kryerjen e këtij aktiviteti, prodhim materialeve ndërtimi, Shoqëria “RE &AL” sh.p.k ka punësuar specialistë prodhimi betonesh dhe përdoruesit e makinerive të transportit dhe përdorimit të tyre si njohës të mirë të kësaj teknologjie.

Teknologjia që do të përdoret për prodhimin e betoneve, është bashkëkohore e cila përdor linjat automatike të peshimit të lëndëve të para, përzierjes së tyre dhe transportimit të mekanizuar për në objektin e përdorimit të tyre. Meqë cikli është pothuaj i mbyllur dhe i automatizuar, pasi lëndët e para (inerte, çimento, granil , rërë) nga bunkerët kalojnë në dozatorët dhe më tej në impiantin për të prodhuar beton, funksionimi i linjës nuk shkakton pluhura. Me produktin përfundimtar që është betoni dhe elementët e tjerë prej betoni, do të furnizohet popullata dhe subjektet ndërtuese për qëllime ndërtimi dhe furnizimin e bizneseve që kanë nevojë për këto lëndë.

Në hapësirën e territorit ku do të zhvillohet veprimtaria është instaluar teknologjia që shërben për ushtrimin e veprimtarisë si dhe është ndërtuar infrastruktura e shërbimeve mbështetëse të operacioneve. Ndër njësitë dhe veprat kryesore të projektit janë:

- Sheshi depozitimit të materialit;
- Linja e prodhimit të betonit dhe elementëve të tij që përbëhet: Sillose vertikale 2 copë; Bunkerët e lëndës së parë për depozitim rëre, granili 5-10mm e 10-20mm; Transpotierët e furnizimit për në përzierës; Linja e furnizimit të çimentos nga silloset për në përzierës; Përzjerësi materialeve me ujë, tip ocmer multiniks; Linjë për furnizimin ujë; Bunkerit produktit e ulluku i furnizimit me beton në autobetonjerë.

- Sheshi Parkimit të automjeteve+garazhi;
- Magazina;
- Zyra e kantjerit ;
- Kabinë elektrike 100kVA;
- Kapaciteti përpunues maksimal 60 m³/orë;

Krahas tyre është ndërtuar

- 1.Sistemi i kanalizimeve dhe parandalimit të ndotjes së mjedisit, puseta dhe kanale mbledhës të ujrave.
- 2.Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, fikse zjarri portative, kosha metalike, tabela sinjalizuese, rezervuarë uji i lidhur me një pompë që siguron ujë me presjon në të gjithë ambjentet e punës.
- 3.Sistemi i rrjetit elektrik, telefonik dhe atij hidrik për ushtrimin e veprimtarisë.
4. Sistemi i brendëshëm rrugor.

Përshkrimi i proceseve teknologjike.

Betoni është një prodhim i përbërë që fitohet me përzierjen e çimentos, agregatit, ujit dhe eventualisht shtesave të posaçme kimike (aditiveve). Brumi që fitohet nga kjo përzierje, si pasojë e zhvillimit të proceseve fiziko-kimike fillon të lidhë e me kohë edhe të ngurtësohet.

Teknologjia e betonit është shkencë që merret me prodhimin e betonit në të gjitha fazat e procesit teknologjik të tij që janë:

- Projektimit të përzierjes (recetës).
- Përzierjes (homogjenizimit) të brumit.
- Transportimi i brumit.
- Vendosjes së brumit të betonit në vepër (në pahi).
- Dendësimin (trusjen, ngjeshjen) e betonit të njomë.
- Mirëmbajtjes së betonit të njomë.

Betoni përveç që është një material me përbërje komponentale ai kalon edhe në procese dhe veprime teknologjike specifike të cilat dukshëm mund të ndikojnë në rezultatet përfundimtare të kualitetit të tij. Problemi është edhe më i madh duke marrë parasysh se në teknologjinë e prodhimit të betonit marrin pjesë shumë aktorë të cilët nuk e kanë nivelin e njëjtë profesional, gjë që edhe më tepër e ndërlikon problemin.

Qëllimi i teknologjisë së prodhimit të betonit është që me materiale përbërëse adekuate dhe mjete teknike që i kemi në dispozicion dhe kuadër profesional, të fitohet beton me veti të kërkuara teknologjike gjersa është në gjendje brumore, kurse me karakteristika të domosdoshme teknike në gjendje të ngurtësuar, çfarë kërkohen me projektin e konstruksionit, apo me kushte të veçanta teknike.

Kërkesat që parashtrihen mund të jenë:

- Vetëm Klasa e betonit ($C_{f_{ck}}/f_{ck,cube}$),

- Klasa e betonit dhe ndonjë veti e posaçme e tij, si p.sh. Klasa e ekspozitetit, XCl, XSi, XDi, XF_r.

Kualiteti i betonit dhe faktorët e kualitetit

Fjala “kualiteti i betonit” paraqet një kuptim relativ jo plotësisht të definuar, sepse ka të bëjë me një kuptim me domethënie mjaft të gjerë. Shpesh, në praktikë kualiteti i betonit identifikohet me soliditetin e tij në shtypje (kryesisht me Klasën e tij, C). Një përvetësim identifikues i tillë do ta thjeshtonte problemin, mirëpo shtrohet pyetja se në çfarë mase është përmbushur kuptimi i definicionit mbi

kualitetin e betonit, kjo nga arsyeja se soliditeti mekanik (fck) kryesisht klasa e betonit (C) paraqet vetëm një tregues të kualitetit të betonit, por jo edhe të gjitha aspektet e tjera kualitative të betonit.

Në praktikë, për ndonjë objekt të caktuar nga betoni mund të kërkohen edhe veti dhe karakteristika të tjera, si p.sh. për ndonjë objekt hidroteknik mund të kërkohet papërshkueshmëria nga uji (XDi), apo qëndrueshmëria ndaj ngricave (XFj), apo rezistenca kimike e betonit (XSk) etj. Prandaj në këto raste përveç Klasës së betonit si karakteristikë më përfaqësuese e betonit duhet të dëshmoohen edhe vetitë e tjera të nevojshme të betonit si p.sh. C25/30, XC2, apo C35/45 XS3 etj.

Në këtë mënyrë është definuar në tërësi lloji dhe kualiteti i kërkuar i betonit për rastin konkret..

Përveç vetive të betonit të ngurtësuar në kuadër të kuptimit **“kualitet i betonit”** duhen përfshirë edhe vetitë e brumit të betonit siç janë: aftësia e brumit që sa më lehtë të vendoset në vepër e shprehur me t.aq. **Konsistenca e brumit të betonit**, punueshmëria e brumit të betonit (rrafshimi sipërfaqësor pa vëshirësi), kohezioni, shmangia e segregimit etj.

Në vetitë e brumit të betonit dhe betonit të ngurtësuar kryesisht ndikojnë këta faktorë:

1. *Lloji, klasa dhe sasia e çimentos ;*
2. *Lloji, përbërja granulometrike dhe kokrra maksimale e agregatit;*
3. *Pastërtia e agregatit (sasia e thërmëve nën 0.063mm. dhe materiet organike;*
4. *Soliditeti mekanik i agregatit;*
5. *Kualiteti i ujit me të cilin përgatitet betoni ;*
6. *Lloji dhe kualiteti i shtesave kimike në beton (aditiveti);*
7. *Raporti sasior i pjesëve përbërse të betonit (receta e betonit);*
8. *Mënyra dhe kohëzgjatja e përzierjes së brumit të betonit ;Lloji i mjetit transportues dhe largësia e transportit të brumit të betonit ;*
9. *Mënyra e hedhjes dhe vendosjes së betonit në vepër (lartësia e hedhjes së betonit në objekt, trashësia e shtresës);*
10. *Mjeti dhe efikasiteti i dendësimit (ngjeshjes) së brumit të betonit ;*
11. *Mënyra dhe kohëzgjatja e mirëmbajtjes të betonit të njomë në periudhën e ngurtësimit;*
12. *Kushtet termo-hidrometrike që ndodhen gjatë kryerjes së punimeve të betonit (verës – dimërit).*

Teknologjia e prodhimit të betonit është teknologji e thjeshtë e standarteve europiane.

Produkte të këtij impianti do të jenë betoni i markave të ndryshme sipas kërkesave të tregut. Linja e prodhimit ka një kapacitet prodhues variabël 80m³/orë dhe punon me cikël të mbyllur. Produkti i këtij impianti do të furnizoje industrinë e ndërtimit në zonë e më gjerë.

Në bazë të fraksioneve inerte të përdorura, raporteve midis tyre dhe aditiveve të lidhjes së granulave (çimento) në fabrikë do të prodhohen si më poshtë:

Masa volumetrike relative e betonit të prodhuar do të jetë 2371 Kg/m³.

Foto Impianti i prodhimit të betonit.



Tabela Të dhëna të fabrikës së prodhimit të betonit dhe elementeve prej betoni

<i>Rërë %</i>	<i>Granil 1 -2 %</i>	<i>Cimento (kg)</i>	<i>Marka e betonit</i>
40%	60%	220	M – 100
40%	60%	270	M - 150
40%	60%	295	M – 200
40%	60%	355	M - 350

Lëndët e para

Lënda e parë që përdoret për prodhimin e betonit për ndërtim janë kryesisht materiale inerte që merren nga subjekte që përpunojnë inerte nga karrierat dhe lumi dhe që përfaqësojnë materiale me konsistencë zhavori apo rëre.



- Inertet

Të dhënat e shkurtëra mbi përbërjen e materialeve lumore e shkëmbore janë pak a shumë si më poshtë:

Tabela 03. Përmbajtja Mineralogjik e Agregatit

Klasat	+2.5mm (0.2%)	+1,25 mm (0.3%)	0.63 mm (15%)	+0.32 mm (60%)	+0.15mm (25,5%)
Copa karbonate	-	-		35%	36%
Copa Ranore	30%		22%	20%	15%
Gëlqerore	25%	28%	32%		
Kalcit	3%	-	5%	5%	10%
Kuarc i pastër	10%	12%	12%	15%	18%
Copa dru/qymyr	2 %	-			
Agregat shkëmb.	30%	-	28%	20%	20%
Agreg.magmatik	-	30%			
Agreg.ranor	-	30%			
Mika	-	-	Deri 1%		Deri 1%

KARAKTERISTIKAT E LINJES DHE SKEMA E PROÇESIT TE PRODHIMIT

Karakteristikat dhe sasia e lëndëve të para ndihmëse. Produkti i gatshëm që do të prodhohet është betoni i markave të ndryshme. Në fillim është një përzierje rëre me zallë të përmasave të ndryshme dhe të përçinëve të ndryshme të cilave u hidhet ujë, dhe me autobetonierë bëhet përzierja deri sa të vejë tek konsumatori. Çertifikata e analizave të këtyre lëndëve tregon se këto lëndë plotësojnë standartin teknik të përdorimit.

Në industrinë e materialeve të ndërtimit për prodhimin e betoneve përdoret lëndë inerte të përpunuara në linjat e inerteve të marra nga karriera që posedon vetë kjo shoqëri, inertet e përpunuara lumore me granulometri të ndryshme që shërbejnë si lëndë e parë për prodhimin e betonit.

Analiza e rërës së fraksionit të imët që përdoret në këtë proces teknologjik ka këto tregues :

Pesha specifike 2.58 -2.6

Lagështia varion sipas stinëve deri ne 12 %

Aciditeti dhe alkaliteti (Ph 6-6.5)

Fortësia 900-1350 kg/cm²

Përsa i takon analizave të përbërjes së çimentos, çdo prodhim çimentoje blihet me çertifikatën e saj brenda standarteve sipas markave të betonit. Ky proces është një përzierje rëre guri i coptuar të përmasave të ndryshme të cilëve u shtohet uji dhe çimentoja kur nëpërmjet autobetonierës, bëhet përzierja deri sa të vejë tek konsumatori. Për betone mbi bazë guri janë këto përzierje. Betoni është i markave të ndryshme.

Markat e betonit që prodhohen janë :

Marka 100

-1 ton lëndë inerte a-45% rërë

b-55% (zall 5-10 mm + zall 10-20 mm)

c-çimento 220 kg

Marka 150 -1 ton lëndë inerte

a-45% rërë

b-55% (zall 5-10 mm + zall 10-20 mm)

c-çimento 268 kg

Betoni i markës 200

Çimento tipo	çimento 42.5II /AI	Pesha 313 Kg/m ³
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	47%	832 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	15%	250 kg/m ³
Granil 10-20mm	38%	636 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raportit ujit çimentos		(a/c) 0.8
Pesha specifike e përzierjes		2.282 kg/m ³
Klasa e konstitencës		S5

Betoni i markës 250

Çimento tipo	çimento 42.5II /AI	Pesha 347 Kg/m ³
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	46%	800kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	15%	245kg/m ³
Granil 10-20mm	39%	642 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raportit ujit çimentos		(a/c) 0.72
Pesha specifike e përzierjes		2.285 kg/m ³
Klasa e konstitences		S5

Betoni i markes 300

Çimento tipo	çimento 42.5II /AI	Pesha 381Kg/m ³
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rërë guri	45%	768kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14%	225 kg/m ³
Granil 10-20mm	41%	662 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raportit ujit çimentos		(a/c) 0.66
Pesha specifike e përzierjes		2.287 kg/m ³
Klasa e konstitencës		S5

Betoni i markes 350

Çimento tipo	çimento 42.5II /AI	Pesha 455 Kg/m ³
Diametri maksimal		31.5mm

Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	43%	736 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14%	220 kg/m ³
Granil 10-20mm	43%	665 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raportit ujit çimentos		(a/c) 0.6
Pesha specifike e përzierjes		2.289 kg/m ³
Klasa e konstitencës		S5

Betoni i markes 400

Çimento tipo	çimento 42.5II /A1	Pesha 455 Kg/m ³
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	44%	704 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14%	216 kg/m ³
Granil 10-20mm	42%	666 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raportit ujit çimentos		(a/c) 0.55
Pesha specifike e përzierjes		2.292 kg/m ³ Klasa e konstitencës
S5		

Përshkrimi i procesit teknologjik të punës.

Materialet inerte që do të përdoren për prodhimin e betonit sipas klasave të ndryshme do të jenë të cilësisë së lartë dhe conform kushteve të cilësisë për këto produkte. Inerti që do të përdoret është paraprakisht i larë (ai merret nga subjekte që kanë aktivitet prodhim inertesh).

Fabrika e prodhimit të betonit dhe elementëve prej betoni përbëhet nga sheshi i depozitimit të ruajtjes së fraksioneve të granilit dhe rërës dhe dy sillose për depozitimin e çimentos. Sistemi i drejtimit të prodhimit, ndodhet në një kabinë, e cila është elektronike me parametra bashkëkohore.

Markat e betonit prodhohen sipas kushteve teknike teknologjike dhe realizohen në funksion të kërkesave të subjekteve juridike dhe fizike të bazuara në projektet e preventivat e hartuara.

Prodhimi i betonit realizohet sipas skemës së mëposhtme: Raporti për të prodhuar beton është 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndërsa uji është raporti u/ç=0.6 pra për një kapacitet mesatar prej 100m³/h, arrijmë në përfundimin se këtij impianti do ti duhen rreth 48t çimento, 96t rërë, 192t çakëll apo zall, ndërsa ujë rreth 29m³/h.

Prodhimi – përzierja e betonit

Gjatë prodhimit të betonit, përzierja e komponenteve duhet të bëhet mirë në mënyrë që të fitohet një brumë homogjen i betonit. Përveç në raste të veçanta, përzierja e brumit të betonit duhet të bëhet me përzierse automatike, të cilat në bazë të mënyrës së punës mund të jenë: me rrënjë të lirë ose me veprim të detyruar. Dozimi i pjesëve përbërëse duhet të bëhet në masë (peshë) e jo në vëllim. Koha optimale e përzierjes është 1÷3 min.

Foto Nr. 10 Skema e Funkzionimit të Objektivit "Impjant për Prodhime Betoni"





Foto Skema e Funkzionimit të Objektivit "Impjant për Prodhime Betoni"



Në lidhje me ngarkimin dhe transportin është parashikuar që pajisjet do të përbëhen nga makina ngarkuese, kamion vetëshkarkues, etj. Kjo zgjidhje bëhet për shkak të adaptueshmërisë dhe fleksibilitetit të lartë që kanë këto lloj pajisje, shkallës së lartë të disponueshmërisë, si dhe mundësinë për t'i kombinuar ato për të realizuar punime të ndryshme sipas nevojave të prodhimit.

Nevojat për ngarkim përcaktohen nga numri i kamionëve të nevojshëm që varen nga distanca e transportimit, disponueshmëria për punë e makinave ngarkuese dhe e kamionëve, orët e punës në dispozicion për ditë/turn, etj. Koha në dispozicion për ngarkim është 8 orë/turn ose ditë. Koha e nevojshme për një cikël të plotë të makinës ngarkuese për të ngarkuar materialin nga pircu me materiale në kamion është 60 minuta. Koeficienti i mbushjes së kovës së makinës ngarkuese zakonisht është 80%.

Përshkrimi dhe Volumet e Punimeve.

Punimet konsistojnë në transportimin, depozitimin dhe përpunimin e materialeve inerte për prodhim betoni. Punimet e instalimit konsistojnë në transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportierë, profile të ndarjes së vend-depozitimit të inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Skema teknologjike e prodhimit të betoneve.

Prodhimi i betonit është një proces zinxhir që realizohet në linjën përkatëse teknologjike. Ky subjekt prodhues i betoneve njihet si subjekt serioz.

Në bazë të makinerive të zgjedhura dhe skemës së zbatuar kjo linjë konkuron dhe do të konkurojë denjësisht në tregun duke realizuar prodhimin e markave të ndryshme të betonit sipas kërkesave në teknologjinë e ndërtimit.

Për të patur një garanci për cilësinë e betoneve dhe për mbarëvajtjen e aktivitetit, subjekti mendon që në të ardhme të ngrejë një laborator për analizën e prodhimeve të kësaj linje.

Lënda e parë (inerte lumore ose shkëmbore të përpunuara), çohen në bunkerët përkatës për materiale inerte të ndara në bokse të ndryshëm me 4 dimensione :për rërë 0-2mm, fraksioni 5- 10mm, fraksionin 10-20mm. Bokset e inerteve kanë një kapacitet 40m³, prej këtej këto fraksione kalojnë në peshoren elektronike për realizimin e recepturave sipas markës së betonit të prodhuar.



Nga peshorja elektronike materiali kalon në përzierjen i cili siguron përzierjen uniforme të materialit të futur. Këtu nëpërmjet shnekut të çimentos shtohet sasia e çimentos duke peshuar paraprakisht me një peshore tjetër me kapacitet 5.000kg, të komanduara sipas recepturave përkatëse të markave të ndryshme të betoneve të ndryshme.

Linja ka 2 sillose për depozitimin e çimentove sipas markës së dhënë më lart. Prej këtej, me ndihmën e shnekut të hermetizuar kalon në autobetonierë e cila xhiron me rreth 60 rotullime në minutë ku finalizohet produkti bojaku uji + çimento.

Uji merret nga rezervuari me linjë të rregullt me sistem komandimi ku sasia e ujit të nevojshëm matet me kontaktiler aparat matës së sasisë së ujit në litra.

Pas përgatitjes së kësaj përzierje, me xhiro maksimale të autobetonierës hidhet materiali inert me komandim për hapjen e bakaportave të bokseve të peshores të materialeve inerte sipas recepturave që kërkon marka e betonit. Gjithë sistemi i transportit të materialit, përzierjes dhe peshimit është një sistem automatik i cili sigurohet nga vetë konstruksioni i pajisjeve që përbëjnë këtë linjë teknologjike.

Kjo linjë është mjaft e thjeshtë dhe realizohet nëpërmjet instalimit të një sillosi i cili furnizohet nëpërmjet autocinternave që transportojnë çimento. Prej këtej ajo me anë të shnekut transportohet për te peshuar dhe për t'u përzier me lëndë të tjera (inerte) për të prodhuar markën e betonit të kërkuar nga klientët.

Në linjën e prodhimit është instaluar dhe linja e prodhimit të ajrit të komprimuar për pneumotransportin

e çimentos nga sillosi. Autobetonierët janë në gjendje të mirë teknike dhe nuk derdhin asnjë lloj material në rrugë. Në pistën e depozitimit të materialeve inerte është instaluar një linjë uji për spërkatje për të mos lejuar ngritjen e pluhurave në ajër.

Foto Transporti i betonit



Transporti i brumit të betonit paraqet një proces teknologjik të rëndësishëm dhe delikat në kuadër të kryerjes së punimeve betonike. Prandaj gjatë transportimit të brumit të betonit duhet patur kujdes dy gjëra:

- Segregimit (si pasojë e dridhjeve që ndodhin gjatë transportit);
- Ndryshimi i përbërjes së betonit (rrjedhja e qumështit (lëngut) të çimentos dhe humbja e sasisë së ujit nga avullimi).

Parametër i rëndësishëm gjatë transportit të brumit të betonit në largësi më të madhe paraqet koha (afatet) e lidhjes së çimentos në beton, sidomos gjatë stinës së verës. Si parametër mund të merret temperatura e betonit p.sh. për :

Tb=5 – 10 °C koha e transportit t 2h ,


Tb=10 – 20 °C koha e transportit t 1.5h,

Tb=20 – 30 °C koha e transportit t 45' .

Vendosja dhe hedhja e betonit në vepër

Gjatë hedhjes së betonit në vepër duhet patur kujdes që ai të vendoset (hidhet) sipas një orari të caktuar në mënyrë që të arrihet "saldimi" në mes betonit paraprak dhe betonit të ri. D.m.th. betonimi duhet të bëhet me anën e a.q. kampadave. Po ashtu duhet patur kujdes që hedhja e betonit mos të bëhet nga lartësia mbi 1.5÷2.0m, sepse vjen deri tek segregacioni, ndërsa shtresat e betonit nuk duhet të jenë mbi 60cm për arsye të vibrimit.

Foto Nr. 19



Ngjeshja apo dendësimi i betonit

Betoni i porsa vendosur në vepër ka mjaft zbrazëtira, dhe nëse do të lihet të ngurtësohet do të fitohet gjithashtu një beton por me veti të dobëta dhe i segreguar. Prandaj, fill pas vendosjes së betonit në vepër është e domosdoshme që ai të ngjeshet ose të dendësohet. Mjetet më efikase për dendësimin e betonit janë.

Mirëvajtja e betonit të njomë

Për hidratimin optimal të çimentos dhe ngurtësimin e rregullt të betonit, temperatura më e volitshme e ambientit është $15 \pm 20^\circ\text{C}$, ndërsa lagështia relative $\sim 95\%$. Në temperatura më të ulëta dhe në ato negative ngurtësimi i betonit ngadalsohet dukshëm madje edhe ndërpritet, kurse uji në të ngrihet, shkrihet dhe kështu e shkatërron betonin e njomë.

Nga ana tjetër, me rritjen e temperaturës dhe pakësimin e lagështisë natyrore të rrethinës, një pjesë e çimentos nuk mund të hidratizohet, prandaj edhe kualiteti i betonit bie mjaft.

Me humbjen e ujit sipërfaqësor, betoni pëson tkurrje të mëdha e në të paraqiten çarje dhe plasaritje. Prandaj, është detyrë e domosdoshme që të pengohet avullimi apo humbja e ujit nga betoni në fazën e lidhjes dhe në fazën fillestare të ngurtësimit.

Mirëmbajtja e betonit në këtë periudhë (së paku 7 ditë) mund të bëhet me ujitje sipërfaqësore (stërpikje), mbulim me letra, thasë, lecka, etj.

Sot, ekzistojnë edhe disa preparate si p.sh. antisol, me të cilat stërpiket sipërfaqja e betonit dhe kështu krijohet një cipë e hollë në formë filmi, i cili pengon avullimin e ujit nga betoni i njomë.

Lëndët ndihmëse:

→ Çimento

→ Energjia elektrike me fuqi 40 ke merret nga rrjeti kryesor i energjisë elektrike të zonës përreth sipas kontratës të bërë nga vetë pronari i kësaj firme me CEZ.

→ Uji i cili merret nga linja e ujësjellësit

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe për nevoja higjieno - sanitare, bëhet përmes lidhjes me magjistralin kryesorë të zonës dhe që kalon në afërsi të objektit.

Kanalizimet

Në përputhje me përbërjen e ujrave mbledhës në sheshin e ndërtimit të objektit janë ndërtuar sistemet ndarës dhe kanalizimet.

- ujrat e përditshme (komunale)
- ujrat sipërfaqësore (të shiut)

Nëpërmjet kanalizimeve bëhet ndarja e ujrave rrjedhës (komunalë) nga ato të objekteve. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave sipërfaqësore dhe ato të shiut jashtë objektit bëhet me tubacione betoni me diameter 200 dhe 300 mm. Pusetat në rrjetin e kanalizimeve të ujrave janë të realizuara me betonarme.

Furnizimi me energji elektrike dhe ndërlidhja

Në përbërje të pjesës elektrike të projektit përfshihen: zgjidhja e problemeve të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve elektrike, të ndriçimit elektrik, të mbrojtjes nga rënia nën tension, të mbrojtjes nga rrymat elektrostatische të objekteve të projektuara etj.

Pjesa elektroteknike e projektit është përpunuar në bazë të të dhënave dhe kërkesave të detyrës së projektimit dhe gjithashtu të zgjedhjeve teknike në funksion të proceseve të ndryshme. Gjatë projektimit janë shfrytëzuar dokumentat normative vepruese dhe normat ndërkombëtare të Komisionit Ndërkombëtar të Elektroteknikes (IEC). Tensioni sekondar i furnizimit të pajisjeve të makinerive teknologjike është 0.4kv.

Burimet e furnizimit me energji elektrike

Energjia e nevojshme për përdorimin në stacion sigurohet nga linja ajrore e rrjetit 6kV e cila kalon anës rrugës para stacionit. Një kampsat e linjës është parashikuar që të futet me kabëll TM nën tokë për arsye sigurie meqenëse do të kalojnë autobotet dhe makinat e mëdha. Për të siguruar një shfrytëzim normal të stacionit meqenëse furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti 6kV i cili nuk e ka sigurinë dhe kualitetin e rrjetit 20kV, do të instalohet në paralel një gjenerator 82,5kVA i cili do të hyjë automatikisht në punë menjëherë kur do të ketë ndërprerje të energjisë.

Rrjeti i tensionit të ulët

Rrjeti tensionit të ulët (0.4kV/50Hz) të ushqimit të fuqisë motorike, ndriçimit, matjes, sigurisë, zyrave dhe shërbimit do të realizohet sipas normave dhe standarteve teknike Europiane. Për karakterin e objektit, sistemi i shpërndarjes 0.4KV do të jetë i formës TN-S. Krahas tij është parashikuar edhe mbrojtja diferenciale e linjave për të shmangur lidhjen e shkëndijave në rast rrjedhje në izolacionin e rrjetit elektrik. Rrjeti kabllor do të ndërtohet i mbrojtur dhe me cilësi zjarrduruese.

Linjat kabllore të futura nëpër tubat PVC, mbi trasen e të cilave do kalojnë kamjona të tonazhit të madh do të futen brenda tubave të betonit ose çelikut me diametër 200mm deri 300 mm. Daljet e kabllave në vendet e tjera me rrezik - zjarri do të jenë në tuba zingato dhe tuba gome zjarrduruese me skermo teli.

Kontrolli i parametrave teknologjike dhe komandimi i proceseve të punës

Linjat e sistemit të kontrollit parashikohen:

- Të jenë të mbrojtura me shkarkues ndaj mbitensioneve të shkaktuara nga shkarkimet atmosferike.
- Komandimi i procesit të punës në objekt, në varësi të karakterit të tij, parashikohet të jetë lokal apo i programuar.
- Komandimi i pompave parashikohet nëpërmjet kuadrove lokale që mundësojnë punën në mënyrë automatike me anë të galexhantave elektrike apo në mënyrë manuale.
- Në rastin e pompave të karburantit, komandimi i tyre parashikohet i programuar nga vendi i mbushjes, nga ku edhe mund të autorizohet punimi si komandin lokal për raste remonti.

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike dhe ngarkesat elektrostatische

Fenomeni i shkarkesave atmosferike dhe elektrostatische është rrezik permanent dhe shumë i aftë të shkaktojë zjarre të fuqishme. Mbrojtja e pikës së karburantit për nevoja vetjake nga shkarkimet atmosferike nuk kërkon përdorimin e shtizave rrufepritëse mbasi trashësia e pareteve të këtyre depozitave është më e madhe se 4mm.

- Tokëzimi i depozitave është parashikuar si një konfigurim terminalesh të bashkuara në një.

- Ky konfigurim formon konture bashkimesh të cilët reduktojnë ndjeshëm diferencat potenciale që lindin në objekt në rast shkarkimesh atmosferike, në sistem të përgjithshëm tokëzimi, ku është përfshirë edhe tokëzimi i kabinës elektrike.
- Për të arritur vlerën e kërkuar të rezistencës së tokëzimit të sistemit rrufepritës nën 10 Ohm në kushtet e një sheshi të ngritur me materiale inerte, impjanti i tokëzimit të depozitës do të përforcohet me elektroda të zinguara dhe të gjata 3m për të arritur në shtresat e tokës me rezistencë specifike të ulët, prandaj sistemi mbrojtjes nga rrufetë do të bëhet për depozitat me sistemin e kombinuar të tokëzimit.
- Shkarkesat elektrostатike lindin edhe gjatë lëvizjes së lëngjeve nëpër tubacione, prandaj të gjitha tubacionet, flaxhimet në bashkimet e tyre, etj., do të bëhen me ura bashkimi me saldim telë çeliku me diametër 6 deri 8mm ose telë tokëzimi me kapikorta duke i lidhur me rrjetin e tokëzimit.

Ndriçimi i objektit dhe nevoja të tjera

- Ndriçimi i objektit është parashikuar me shtylla të larta metalike të zinguara 9-12ml të paisura me plafonier IP55 me llampa sodjumi të presionit të lartë me fuqi deri 250E-300E.
- Komandimi i ndriçimit parashikohet të bëhet automatik me rele dhe manual nga kabina e rojes.
- Për vetë lartësinë e konsiderueshme të tyre, është parashikuar për çdo shtyllë një impjant tokëzimi lokal i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe nga rreziku i tensionit të prekjes.
- Në objekt është parashikuar edhe një rrjet pikash për nevoja remonti, të formuar nga kaseta prizash industriale me shkallë mbrojtjeje IP67, si dhe kaseta furnizimi të dy portave të jashtme të objektit të mekanizuara.

Ndriçimi Elektrik

Në projekt parashikohet ndriçimi i jashtëm i territorit. Ai realizohet me prozhektorë me llampa halogjene dhe llampa inkadeshente të mbrojtura, të vendosura në shtylla prej konstruksioni metalik. Komandimi i ndriçimit realizohet nga operatori direkt në dhënie e tij të shërbimit.

Rrjeti elektrik i sistemit të ndriçimit realizohet me kablllo prej bakri. Seksioni i kabllit zgjidhet sipas rrymës së ngarkesës dhe rënive të lejuara të tensionit. Mbrojtja e rrjetit të sistemit të ndriçimit realizohet me çkyqe automatike të vendosura në panelin përkatës.

Ndriçimi i brendshëm elektrik

Në projekt parashikohet tensioni i rrymës së punës (-220V, -12V) tensioni i avarisë (-12V) dhe tensioni i remontit për ndriçimin e ambientit (-36 V). Tipi dhe vendosja e ndriçuesve është zgjedhur në vartësi të mjedisit rrethues, në përputhje me kategoritë e punimeve dhe kushteve pamore.

Rrjeti i sistemit të ndriçimit të brendshëm realizohet me kablllo prej bakri. Seksioni i kabllit zgjidhet sipas rrymës së ngarkesës dhe rënive të lejuara të tensionit. Mbrojtja e rrjetit të sistemit të ndriçimit

realizohet me çkyçje automatike të vendosura në panelin përkatës.

Mbrojtja e objektit

Mbrojtja nga rënia nën tension

Tokëzimi i pajisjeve dhe makinerive elektrike realizohet me lidhjen e korpuseve metalike komplekse, që kanë në përbërjen e tyre elektroda metalike të lidhura midis tyre me shirit metalik. Për modifikimin e pajisjeve elektrike, shfrytëzohen nulet e kablllove ushqyese. Vlera e rezistencës në kalimin e rrymës është e ndryshme dhe lëviz nga 40Ohm në 120ohm

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike.

Në kuadrin e mbrojtjes së objektit nga mundësia e lindjes së zjarrit, është parashikuar edhe mbrojtja e tij nga shkarkimet atmosferike. Të gjithë objektet, dhe ato me lartësi të madhe të ndodhura brenda territorit të sheshit të objektit të ndërtuar, si shtyllat e ndriçimit me prozhektor dhe ato të furnizimit me energji elektrike përfshihen në sistemin e mbrojtjes nga rënia nën tension.

Masat ndaj zjarrit.

Për të ulur shkallën e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e shoqërisë do të merren masat ndaj mbrojtjes së zjarrit. Hidrantet do të vendosen në zona të dukshme dhe punonjësit do të instruktohen për përdorimin e tyre në raste aksidentesh. Punëdhënësi pas vlerësimit të rreziqeve të zjarrit dhe në bazë të planit të emergjencës, i përcakton punëtorët përgjegjës për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit, luftën kundër zjarrit dhe menaxhimit të emergjencave.

Detyra e shoqërisë është, jo vetëm të sigurojë që puna të kryhet në bazë të programit, por edhe që ajo të kryhet në kushte sigurie, duke respektuar masat e vëna në dispozicion nga drejtuesit teknikë, rregullat mbi kujdesin në punë, si dhe duke pretenduar që punëtorët të respektojnë standartet dhe të përdorin, nëse nevojitet, pajisje personale mbrojtëse si dhe të kontrollojnë funksionimin e tyre.

Në raste zjarresh do të bëhet aktivizimi i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit si dhe njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësisve të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca). Rrugët hyrëse në linjë janë projektuar në mënyrë të tillë që të ketë lehtësi për hyrjen e njësisve të specializuara në rastet emergjente.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT

Të përgjithshme.

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm. Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në tërësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e funksionimit, pasi nuk përfshihen procese ndërtimi në këtë Fabrikë. Nuk marrim në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do të vazhdojë të jetë i tillë në vazhdimësi. Ky aktivitet nuk prek zona me bimësi, ndodhet në brendësi të sheshit të miratuar për shfrytëzim.

Vlerësim i impakteve kryesore në mjedis

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
2. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
3. Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
4. Parimi i zëvendësimit ose kompensimit
5. Parimi i qasjes së integruar

6. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
7. Parimi "Ndotësi paguan"
8. Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
9. Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Ky vlerësim kryhet në bazë të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe VKM Nr. 13, datë 04.01.2013 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Sa më sipër raporti i vlerësimit të ndikimeve në mjedis do të vlerësojë:

Ndikimet në ajër;

Ndikimet në ujëra;

Ndikimet në tokë ;

Ndikimet në biodiversitet (mjedisi biologjik);

Ndikimet në mjedisin social-ekonomik;

Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike etj.

Ndikimet e pritshme në mjedis

Ndikimet e analizuara gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit mund të përmblihen sipas elementeve të mjedisit, si më poshtë:

Ky përfshin efektet direkte dhe indirekte, sekondare, të asimiluara, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përkohëshme dhe të përhershme, pozitive dhe negative të projektit.

-Efektet mbi qeniet e gjalla, ndërtesat dhe tipare të tjera të mjedisit të realizuara nga dora e njeriut.

Veprimtaria e prodhimit të betonit nuk ka për bazë asnjë llojë përpunimi kimik apo biologjik si burim ndotjeje apo të çfarëdo lloji tjetër dëmtimi sidomos të ekosistemit pyll apo të ekosistemeve të tjera përreth zonës kontinentale.

Ndikimet në popullsi.

Linja e prodhimit të betonit nuk ndikon në popullsinë e zonës, për pasojë nuk do të ketë ndikime pasuese mjedisore. Kjo sepse përreth zonës nuk ka shumë ndërtesa banimi, përveç se veprimtari të tjera të cilat kryejnë aktivitetin e tyre.

Gjithashtu aktiviteti nuk shoqërohet me zhurma apo emetime të llojeve të tjera në nivele të larta shqetësuese për banorët. Si ndikim pozitiv përmendim punësimin e një numri të vogël të punonjësve e cila zgjidh minimalisht një nga problemet sociale siç është punësimi.

Ndikimet vizuale të aktivitetit në rajonin përreth dhe në pejsazh.

Nuk ka ndikim negativ në pejsazhin natyror të zonës përreth duke shkaktuar tjetërsime të pjesëshme. Nga procesi i linjës së betonit peisazhi në përgjithësi, nuk ka ndryshuar. Kështu që ndikimi i saj është i pa përfillshëm.

Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga aktiviteti gjatë funksionimit normal.

Siç është parashikuar edhe më sipër nga linja e betonit nuk ka emetime të pluhurave në sektorët ku ndodh procesi i prodhimit dhe ngarkim-shkarkimi i materialit. Këto emetime evitohen si pasojë e teknologjisë së njomë që aplikohet në këtë linjë.

Po kështu emetime të pakta vijnë nga përdorimi i fadromës dhe makinave që bien inertin lumorë dhe transportojnë inertet e prodhuara. Këto mjete që emetojnë sasira gazesh janë rezultat i punës së motorrave me djegje të brendëshme, brenda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontroleve teknike.

Nivelet dhe ndikimet e zhurmave të shkaktuara nga aktiviteti.

Linja e betonit, është proces që realizohet në anën e impiantit që në rastin konkret përbëhet nga transportierët, betonieret, aksesorë të tjerë si dhe nga mjetet ndihmëse të transportit që janë fadroma dhe makina.

Siç shikohet i gjithë procesi i linjës e betonit, ngarkimi dhe transporti është i mekanizuar dhe ka vetëm mjete. Këto paisje dhe mjete përsa i takon nivelit të zhurmave i kanë brenda normave të lejuara pasi këto mjete transporti janë të kolauduara periodikisht.

Ndikimet e aktivitetit mbi rrugët dhe transportin lokal.

Linja e betonit ndodhet në zonë bujqësore. Gjatë kryerjes së aktivitetit nuk ka ndryshim të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë projekti nuk ka ndikime në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është i detyruar të mirëmbajë rrugët lokale të transportit me qëllim mbarëvajtjen e mirë të aktivitetit të tij.

Ndikimet e aktivitetit mbi ndërtesat, thesarin historik dhe arkitektonik, veçoritë arkeologjike dhe shqetësime të tjera njerëzore.

